




www.lezha.gov.al

bashkia ime

Botim i Bashkisë Lezhë, Nr. 5, nëntor 2017



Tetori, muaji i sensibilizimit kundër kancerit të gjirit



Miratohet Plani i Përgjithshëm Vendor, fq 5




Bashkia mirëpret vitin e ri shkollor, fq 6



Lezha në Takimin e Qytetarëve Europeanë, fq 8



Turneu "Klarisa Judo Fest", fq 21



Redaksia

Drejtoria e Integritimit në BE dhe Programeve të Zhvillimit
Lajmet: Altin Mema, Rrok Lelçaj, Gjergj Figuri
Fotot: Olsi Tetaj
Redaktorë: Hekuran Koka, Xhulia Lekaj
Design: Hekuran Koka, Evaristo Coli
www.lezha.gov.al, pzhvillimi@lezha.gov.al



përmbajtja

Delegacioni nga Nysa viziton Lezhën	4
Miratohet Plani i Pergjithshëm Vendor	5
Vazhdon puna për kullimin e tokave	6
Dëgjesë publike për buxhetin e vitit të ardhshëm	7
Bashkia Lezhë në Takimin e Qytetarëve Europianë	8
Përurohet Qendra Komunitare në Lezhë	9
Takim sensibilizues për dhunën në familje	10
Sensibilizim ndaj trafikimit të qënieve njerëzore	11
Tetori, muaji i sensibilizimit kundër kancerit të gjirit	12
146- vjetori i lindjes së At Gjergj Fishtës	14
Dita Europiane e Gjuhëve të Huaja	15
14 vjetori i Ditës së Lumturimit të Nënë Terezës	15
Dita Ndërkombëtare e të Drejtës së Informimit	16
Festivali Epiko-Lirik i Matit	16
70-vjetori i studiesit Tonin Çobani	18
Shfaqje teatri tre planësh për fëmijë	19
Turneu "Klarisa Judo Fest"	21

Delegacioni polak i rajonit Nysa viziton Bashkinë Lezhë

1. Czesław Bilobran, Kryetari i Rrethit Nysa, Jan Woźniak - Kryetari i Komunës Otmuhov, Stanisław Zaczyk - Kryetari i Këshillit Bashkiak Otmuhov, Jerzy Baran - Drejtori i Shkollës 8-vjeçare në Otmuchov, Leszek Podruczny - Drejtori i Shkollave në Otmuchów
6. Aleksander Pałański - Këshilltar
7. Anna Korzeniec - Drejtoresha e Departamentit Organizativ
8. Monika Koçalska - Drejtoresha e Departamentit të Infrastrukturës dhe Fondeve Europiane

Miqtë polak u pritën nga kreu i Bashkisë së Lezhës Fran Frrokaj i cili, duke ju uruar mirëseardhjen, i njohti ata me historinë e Lezhës, kulturën, sportin, arsimin dhe resurset turistike që administrojnë kjo bashki me një potencial të fuqishëm për zhvillimin ekonomik të të gjithë rajonit. E shikoj si një mundësi me interes dy palësh, u shpreh Frrokaj, ngritjen e urave të bashkëpunimit në këta sektorë të rëndësishëm mes dy rajoneve tona, ku Bashkia e Lezhës ka çfarë të mësojë nga përvoja e rajonit të Nysas, një vend me demokraci të konsoliduar dhe ekonomi të zhvilluar. “Kjo vizitë veç shkëmbimit të eksperiencave dhe përvojave mes palëve që lidhen me aplikimin e përbashkët për fondet e BE-së, synon edhe bashkëpunimin në fushën e turizmit, arsimin dhe sportin. Ne mirëpresim promovimin e vlerave turistike të të dy rajoneve me qëllim thithjen e sa më shumë vizitorëve e turistëve nga të dy vendet respektive, çka i shërben zhvillimit dhe konsolidimit të këtij sektori me rendësi jetike për rritjen e standartit ekonomik të rajonit dhe komunitetit”, përfundoi fjalën e tij kreu i Bashkisë së Lezhës zoti Fran Frrokaj. Në takim morri pjesë dhe kryetari i Këshil-


lit të Bashkisë Kristian Gjiodaj, i cili i përshëndeti miqtë polak në emër të institucionit që drejton, duke treguar gatishmëri në zgjerimin e këtij bashkëpunimi dypalësh. Ndërkohë drejtuesit dhe anëtarët e delegacionit polak vunë theksin në bashkëpunimin në sektorët e zhvillimit të ekonomisë, kulturës, sportit dhe në veçanti të turizmit, duke synuar sensibilizimin e turistëve polak për të vizituar rajonin e Lezhës, që ka një histori të lavdishme dhe një bregdet të virgjër. Gjithashtu, miqtë polak të rajonit të Nysas premtuan që përvojën e tyre në hartimin e projekteve të BE-së, pasi aderorjnë aty që në vitin 2004, do të jenë të gatshëm ta sjellin në Bashkinë e Lezhës. Miqtë polak vizituan objekte historike të Bashkisë Lezhë



Këshilli Bashkiak i Lezhës miraton Planin e Përgjithshëm vendor

Nën drejtimin e kryetarit Kristian Gjiodaj është mbledhur Këshilli Bashkiak i Lezhës, i cili si pikë të parë të rendit të ditës ka diskutuar rreth strategjisë dhe prezantimit të planit të zhvillimit të territorit. Pas pyetjeve, diskutimeve dhe sugjerimeve të anëtarëve të Këshillit, me shumicë votash ai ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor. Ky plan, veç të tjerash, fokusohet në zhvillimin urban të zonave turistike që ka Lezha. Ndërsa, si pikë e dytë e rendit të ditës ka qënë miratimi i projekt-vendimit për dhënie ndihmë ekonomike familjeve në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuara. Më pas është kaluar në shqyrtimin dhe miratimin e pikave të tjera të rendit të ditës, që kishin të bënin me shkëmbimin e pasurisë tek Njësia Administrative Balldre, përdorim fondi rezervë

për dhënie ndihmë financiare dhe, përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ZRPP. Gjithashtu, në këtë mbledhje u vijua me miratimin e projekt-vendimit për normat e harxhimit të karburantit për mjetet e MZSH-së dhe ato të harxhimit të kaldajave të sistemit të ngrohjes në institucionet arsimore të Bashkisë Lezhë, si dhe shqyrtimin dhe miratimin e projekt-vendimit nr. 7443, “Për miratimin e kalimit të tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi të përfituesve”. Zevëndëskryetari i Bashkisë, Z.Enver Hafizi, dhe drejtorë të drejtorive të ndryshme ishin të pranishëm në këtë mbledhje, dhanë sqarime dhe përgjigjet e duhura për pyetjet e anëtarëve, dhe morën përsipër zgjidhjen e problemeve të parashtruara.



BASHKIA LEZHË PO PUNON PËR KULLIMIN E TOKAVE TË FERMERËVE

Bashkia e Lezhës, me mjetet dhe mundësitë që disponon, po punon me intensitet për pastrimin e kanaleve të dyta e të treta kulluese. Puna është përqëndruar në zonat më problematike si, në Zadrimë, fushen e Torovices, Tresh - Spiten dhe siperfaqet e Njësisë Administrative Shënkoll. Fermerët me tokë bujqësore në keto zona, gjithnjë kanë qënë të ekspozuar ndaj fenomenit përmbytje. Të mbjellat e tyre prej vitesh i kanë marrë ujrën dhe këtë punë që po bën Bashkia e Lezhës e vleresojnë si mjaft cilesore dhe të domosdoshme në parandalimin e përmbytjeve të tokave të tyre bujqësore. Për drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural, Gjovalin Gjeloshi, nevoja për këtë ndërhyrje ka qënë tepër emergjente pasi, nga bllokimi i kanaleve përmbytjet kanë qënë të vazhdueshme dhe, prej shumë vitesh fermerët mb-

jellin e nuk korrin. Në gjithë siperfaqet bujqësore të Lezhës, për periudhën korrik të vitit të kaluar e deri në gjysmën e parë të tetorit të këtij viti janë pastruar e thelluar mbi 86 km kanale të para e të dyta kulluese dhe janë levizur mbi 200 mijë m³ dhera, duke rehabilituar rrjetin kullues në një siperfaqe prej 3000 mijë ha. Krahas njësive të tjera, me intensitet po punohet në Njësinë Administrative Shënkoll ku deri më tani janë pastruar e thelluar afër 20 km kanale kulluese. Kreu i kësaj njesie, Albert Rusti, thekson se fillimisht është ndërhyrë në pikat më problematike dhe gradulisht fenomeni përmbytje po shkon drejt parandalimit. Puna që po bën bashkia për kullimin e fushave të Lezhës është investimi më i dobishëm që shpëton një herë e mirë nga përmbytjet tokat bujqësore dhe të mbjellat e fermerëve.



Kryeministri i vendit zhvilloi në Lezhë dëgjesën për buxhetin e vitit të ardhshëm.

Në këtë takim mori pjesë edhe kryetari i Bashkisë Lezhë z.Fran Frrokaj, i cili e pa të arsyeshme për shkak të interesit qytetar, nga ku i kërkoi Ramës që të financohen projektet e Bashkisë Lezhë. Kryebashkiaku i Lezhës u tregua i prerë që në hapje të diskutimit, gjëja e parë që bëri ishte përcaktimi i “fushës së lojës” ku do të shtrihet ky diskutim, duke kërkuar kështu që në të mirën e qytetarëve të dilnin nga rrafshi politik dhe të përqendroheshin tek ai në dobi të interesit të banorëve të Bashkisë Lezhë. Frrokaj i listoi disa investime të domosdoshme që i duhen zhvillimit të Lezhës, ndërsa çështje më vete mbetet regjistrimi i pronave të fermerëve. Disa nga problemet kryesore të ngritura para Kryeministrit Rama të kryebashkiakut të Lezhës ishin:

1. Rruga e Shëngjinit, duke filluar nga rrethrotullimi, e cila nuk i ngjan aspak një qyteti që e bazon ekonominë tek Turizmi.
2. Problemi i Torovicës, me rrugën dhe sistemet e tjera që, sa më shumë të vonohen aq më shumë e shkretojnë atë zonë dhe gjendjen ekonomike të banorëve të saj.
3. Problem tjetër i cili trashëgohet, që është akut, që ka shumë vite që nuk merr zgjidhje, ka të bëjë me problemin e pronave të fermerëve të ish Ndërmarrjeve Bujqësore të cilët janë të pajisur me akt perdorimi por nuk marrin dot titujt e pronësisë. Kryeministri Rama, duke prekur kërkesat që parashtrroi kreu i bashkisë deklaroi:

1. Sa i takon Shëngjinit, ky mbetet një prioritet i cili do të vihet në zbatim shumë shpejt.
2. Sa i takon problemit të pronës së fermerëve, Kryeministri Rama e pranoi se është e pakuptimtë që fermerët që janë pajisur me tokë sipas Ligjit 7501, kanë marrë tokën dhe të mos marrin titujt. Pavarësisht faktit që Kryeministri e cilësoi si të papranueshme faktin që këta fermerë nuk pajisen dot me titujt e pronësisë, ai nuk dha ndonjë sqarim të ngërçit, shteg apo afat se kur mund të zgjidhet, dhe se cili institucion shtetëror e ka përgjegjësinë konkrete për pajisjen me titujt e pronësisë të fermerëve .



Bashkia Lezhë në Takimin e Qytetarëve Europeanë

Bashkia Lezhë mori pjesë në Takimin e Qytetarëve Europeanë, "Duke kërkuar për kimerën ndërkulturore", që u mbajt në Valongo, Portugali me 16-20 Tetor 2017. Ky takim financohej nga programi "Europa për qytetarët", drejtimi "Binjakëzimi i Qyteteve", thirrja e parë për vitin 2017. Qytetarët e disa qyteteve të binjakëzuara u takuan për të diskutuar mbi diversitetin, multikulturalizimin, të drejtat e njeriut dhe sfidat me të cilat përballet BE dhe synon të ndikojë në jetën e përditshme të pjesëmarrësve duke i lejuar ata që të mësojnë dhe frymëzohen nga njëri-tjetri. Qëllimi kryesor i takimit ishte forcimi i ndjeshmërinë kulturore dhe thellimi i njohurive mbi çështjen e diskriminimit dhe njohjen me praktikën anti-diskriminuese që zbaton secili partner. Pjesëmarrësit u ballafaquan me mënyrën se si ata kategorizojnë botën rreth tyre, duke vënë theksin te stereotipat dhe sa shpesh kjo çon në sjelljet diskriminuese. Programi i seminarit ishte projektuar për të siguruar mundësinë për të shkëmbyer njohuri kulturore, punë në grup rreth diskriminimit në themel, reflektimi mbi jetën në një Evropë multikulturore, posaçërisht mbi të drejtat e emigrantëve dhe refugjatëve. Edhe vetë partnerët



përbënin një mozaik të qartë të Europës dhe fazave të ndryshme të anëtarësimit duke qënë prej shteteve themeluese Formigine (Italia), nga zgjerimi para perdes së hekurt Valongo (Portugalia), zgjerimi pas perdes së hekurt Mioveni (Rumania) dhe vend kandidat Lezha (Shqipëria). Gjithashtu në takim ishin të pranishëm të rinj me kombësi të ndryshme nga EVS, një praktikë e re kjo e Bashkimit European. Bashkia Lezhë u prezantua denjësisht në këtë takim, duke thyer tabutë rreth vendit tonë, dhe duke marrë angazhimin e të gjitha palëve për të vazhduar edhe më tej bashkëpunimin me Bashkinë tonë, me një grup të rinj nëpunësish, Hekuran Koka, Elisjana Frroku, Gentjan Zhubi, Marjana Brunga, Zachary Burdeau (Korpusi i Paqes), Gjovalin Marku, Nertila Nikolli, Florinda Kola dhe Lindita Frroku. Përveç prezantimit dinjitoz dhe mendjehapur në diskutime, të ftuarit mbetën të mahnitur nga prezantimi që iu bë Lezhës me anë të një pjese filmike të shkurtër të përgatitur nga Sektori i Turizmit në Bashki. Pjesë e takimit ishte edhe njohja me praktikën e mira të tre qyteteve portugeze, si Valongo (qyteti mikpritës), Matuzinjo dhe Porto, ky i fundit edhe destinacioni më i mirë në Europë për 2017.



Përrurohet Qendra Komunitare Multifunkionale në Lezhë

Është inaguruar në Lezhë, Qendra Komunitare Multifunkionale, e ngritur falë bashkëpunimit të Bashkisë Lezhë, Eorld Vision dhe organizatës Terre des Hommes. Në ceremoninë e përrurimit ishin të pranishëm zv.kryetarët e Bashkisë Lezhë, z.Enver Hafizi, znj.Alfrida Marku dhe përfaqësues e veprimtarë të shoqatave të ndryshme që veprojnë në Lezhë. Në këtë qendër do të ofrohen shërbime dhe realizohen aktivitete të cilat kanë në fokus mbrojtjen e fëmijëve dhe edukimin e tyre, si dhe fuqizimin e familjes. Kjo qendër komunitare shumë shpejt do të jetë e para ndër disa të tilla. Qendra multifunkionale në lagjen Skënderbeg, dedikuar komunitetit rom e egjiptian për integrimin



sa më të plotë të tyre në shoqëri, si dhe qendra shëndetësore në lagjen "Nënë Tereza" e cila do ti shërbjë shëndetit të nënës dhe fëmijës, janë në fazat përfundimtare dhe shumë shpejt do të jenë në shërbim të banorëve lezhjanë. Nënkryetarja e bashkisë znj. Alfrida Marku nënvizoi domosdoshmërinë e këtij shërbimi duke sjellë në vëmendje, problemet e shumta sociale e ekonomike, rastet në shtim të dhunës në familje, raportimit të këtyre rasteve, si dhe kthimin e shumë familjeve lezhjane nga vende të ndryshme të BE-së të cilat ishin me statusin e azilkërkuesit. Më pas gjithë të pranishmit vizituan e panë nga afër mjediset e kësaj qendre të re.



Takim në Biblioteken e Lezhës për dhunën në familje

Dhuna në familje është një fenomen i përhapur në shoqërinë tonë. Ndodh mes partnerëve të ngushtë, por ndodh edhe në familje. Ndodh në të gjitha klasat shoqërore, pavarësisht moshës, arsimit, fesë, gjendjes ekonomike, etnisë, ose identitetit kulturor. Megjithatë ka një sërë faktorësh që çojnë në dhunë në familje, kjo gjithmonë është e lidhur me pabarazitë dhe çekuilibrin e pushtetit në marrëdhënie. Duke marrë parasysh sa problematik dhe shqetësues është fenomeni i dhunës në marrëdhëniet familjare, sipas kuadrit ligjor është e nevojshme që komuniteti të ndërgjegjësohet dhe sensibilizohet mbi këtë problematikë. Kështu, sektori i Barazisë Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje,

në janar të 2017 ka filluar të bëjë takime bashkëbiseduese e ndërgjegjësuere me komunitetin në të gjitha fshatrat e të gjithë Njësive Administrative të qytetit të Lezhës. Deri më tani janë kryer takime në këto fshatra të qytetit të Lezhës: Markatomaj, Tale 1 dhe Tale 2, Ishull-Lezhë, Bërzanë, Rrilë, Pllanë, Zejmen, Shëngjin, Barbullojë. Këto takime rifilluan këtë sezon me gratë dhe vajzat e qytetit të Lezhës. Në takimin e datës 28.09.2017 të organizuar në ambientet e bibliotekës së qytetit, morën pjesë gra dhe vajza të cilat ndanë me specialistët e Dhunës në Familje, shqetësimet lidhur me këtë fenomen si dhe ofruan mbështetjen e tyre për të referuar rastet e dhunës.



Muaji tetor, muaji i sensibilizimit ndaj trafikimit të qënieve njerëzore

Muaji tetor është i mbushur me aktivitete sensibilizuese kundër trafikimit të qënieve njerëzore. Specialistët e sektorit të Kujdesit Social pranë Bashkisë Lezhë kanë ndërmarrë këtë iniciativë kushtuar Trafikimit të Qënieve Njerëzore. Duke parë rastet e referuara që janë potencial trafikimi, është ndjerë nevoja që të realizohen disa takime gjatë këtij muaji. Konkretisht janë realizuar takime në tre gjimnazë të qytetit të Lezhës (Gjimnazi “Hydajet Lezha”; “Kolin Gjoka” dhe “Karl Gega”). Në këto takime ndërgjegjësuere është bërë e mundur një prezantim me video të një historie të vërtetë trafikimi. Gjithashtu me anë të një materiali të përgatitur në poëer point, u prezantua fenomeni i trafikimit të qënieve njerëzore, ku shpjegohej çështje trafikimi, kush janë format e trafikimit, cilat janë grupet më vulnerabël që mund të


preken nga trafikimi, etj. Trafikimit dhe shfrytëzimit seksual i është dhënë më shumë fokus duke menduar e marrë parasysh se të miturit që vazhdojnë shkollën e mesme, janë më të prekur dhe më të rrezikuar ndaj këtij lloji të trafikimit. Nxënësit e këtyre klasave ishin shumë bashkëpunues gjatë bisedës dhe diskutuan raste të miqve të tyre që mendonin se do të ishin pre e trafikimit. Trafikimi i qënieve njerëzore është një nga problemet sociale më të mprehta që ka prekur mbarë shoqërinë. Ashtu edhe në shoqërinë shqipëtare është mjaft i përhapur si fenomen, pavarësisht se ndoshta nuk dëgjojmë shpesh raste në bisedat e përditshme. Kështu, iu bë thirrje nxënësve të këtyre klasave që të referojnë rastet që dyshojnë se po shfrytëzohen dhe mund të jenë pre e trafikimit, pranë psikologut të shkollës.



Tetori, muaji i sensibilizimit kundër kancerit të gjirit

Në fushatën për informimin dhe ndërgjegjësimin e grave dhe të vajzave për parandalimin e kancerit të gjirit, Bashkia Lezhë ka qënë promotore dhe organizatore e shumë veprimtarive sensibilizuese. Gjatë gjithë muajit tetor është punuar me moton “Bashkë kundër kancerit të gjirit dhe burrat mbështesin fushatën”. Në veprimtarinë përmbyllëse që nisi me ecjen simbolike për mbrotjen kundër kësaj sëmundjeje, morën pjesë drejtues të institucioneve lokale, qytëtarë të Lezhës, përfaqësues të qeverisë, Ambasadorit Amerikan dhe asaj të Bashkimit European. Në mesazhet që u përcollën në këtë takim u theksua se, ka sëmundje të vështira që jo rastësisht prekin njerëzit e fortë, të cilat falë kontrolleve periodike, një sistemi shëndetësor bashkëkohor, dashurisë familjare dhe vendosmërisë për t’ja dalë, mbeten thjesht probleme shëndetësore kalimtare. I tillë është dhe kanceri i gjirit që po të kapet në kohe është plotësisht i shërueshem. Të dhënat në rritje të kësaj sëmundjeje të rëndë, theksuan folësit, i kanë bërë të domosdoshme nismat sensibilizuese dhe veprimtaritë konkrete që lidhen me parandalimin dhe zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Kreu i Bashkisë, Fran Frrokaj, falenderoi bashkëpunëtorët në këtë fushatë për organizimin e sensibilizimeve të tilla në Lezhë dhe ndërkohë u shpreh se nga Lezha, vendi i Besëlidhjes Shqiptare, mund të zejë fill edhe nisma e marrëveshjes paqësuese të politikës shqiptare, që synojnë mbarëvajtjen e vendit tonë drejt integritimit european. Ambasadorja e Bashkimit European, Romana Vlahutin, e cilësoi këtë aktivitet si më të rëndësishmin. Ajo shprehu interes e mbështetje të një jete të shëndetshme për lezhjanët e shqiptarët e në veçanti

për gratë. Ne përpiqemi, vijoi Vlahutin, të përmirësojmë cilësinë e jetës ndaj jush, por përse i përket shëndetit shumë gjëra mbeten në dorën tuaj. Shteti duhet të bëjë më shumë për ju, por edhe ju duhet të jeni të vëmëndshëm në bërjen e analizave e vizitave mjekësore. Ndërsa zëvendës ambasadori i SHBA-së falenderoi Bashkinë e Lezhës për mbështetjen e kësaj fushate, ku evidentoi dhe bashkëpunimin e mirë që kanë patur prej vitesh. Ministrja e Arsimit Lindita Nikolla dhe zv.ministrja e Shëndetësisë Ardiana Jaku, përcollën mesazhet e tyre të ndihmës e sensibilizimit ndaj kësaj sëmundjeje, duke u bërë thirrje grave dhe vajzave që të tregojnë kujdes dhe luftën ndaj kancerit të gjirit ta bëjmë një betejë të fituar. Përsëritën këtë takim edhe përfaqësues të Organizatës botërore të Shëndetësisë si dhe gra të Lezhës që janë prekur nga kjo sëmundje dhe me kujdesin e treguar, duke e kapur në kohë, po e kapërcejnë me sukses atë.



Bashkë kundër kancerit të gjirit

Tetori është muaji i cili i përkushtohet luftës kundër tumorit më të shpeshtë malinj tek femrat. Bashkia Lezhë, në bashkëpunim me “YWCA-Shoqatën Kristjane të Grave Shqiptare”, si dhe me mbështetjen e Spitalit Hygea, organizuan një takim ndërgjegjëses mbi rëndësinë e kontrolleve të rregullta mjekësore me qëllim ekzaminimin në kohë të kancerit të gjirit. Kontrollat e rregullta dhe evidentimi i hershëm i këtij problemi shëndetësor, bëjnë të mundur që kanceri i gjirit të jetë një problem shëndetësor kalimtar. Nënkrëtarja e bashkisë, zj.Alfrida Marku, në fjalën e saj vuri theksin te mungesa e aparaturave bashkëkohore, mungesa e një protokolli bashkëkohor dhe medikamenteve të duhura me të cilat trajtohen pacientët në spitalet tona, në raport me pacientët me të njëjtën diagnozë në shtetet fqinje. Nëse këto 3 elemente janë në standartin e duhur, atëherë, realisht kemi të bëjmë me një trajtim serioz të kancerit të gjirit.

146- vjetori i lindjes së At Gjergj Fishtës

Në 146 vjetorin e lindjes së poetit tonë kombëtar At Gjergj Fishta, në një aktivitet të organizuar nga Bashkia Lezhë, shkolla e Troshanit dhe Mrizi i Zanave, Homeri i letrave shqipe u përkujtua në truallin ku lindi, me një koncert artistik dhe mozaik recitimesh të përzgjedhura nga veprat e tij letrare, të prezantuar në Festivalin "Fishta 2017". Ky festival do të jetë i përvitshëm në çdo përvjetor të lindjes së poetit. Fishta i dha At Gjergjit mbiemrin e madh, kurse At Gjergji i dha lavdinë këtij fshati, Lezhës e mbarë kombit shqiptar. Studuesi i veprës së Fishtës, dr. Tonin Çobani falenderoi Bashkinë për organizimin e këtij aktiviteti dhe u shpreh se ndjehej mirë që ndodhej në këtë ditëlindje të madhe të një poeti të madh si Fishta. Kryetari i Bashkisë së Lezhës z.Fran Frrokaj, inspirues dhe mbështetës i këtij aktiviteti, duke vlerësuar emrin dhe figurën me rrezatim mbarë kombëtar të At Gjergj Fishtës, premtoi se institucioni që ai drejton do të ketë gjithnjë në vëmendje evenimente të rëndësishme si ky, që përkujtojnë e promovojnë këtë figurë të ndritur të Lezhës dhe mbarë kombit tonë. Prefekti i Lezhës Eduart Ndreca theksoi se, për permatat që ka ai, vendlindja e Fishtes nuk është vetëm



këtu në Fishtë të Lezhës por dhe në Konispol në Vermosh, në Vlorë, Kosovë e mbarë trojet shqiptare. Veprimtaritë në përkujtim të poetit tonë kombëtar At Gjergj Fishta, vijuan në gjimnazin "Hydajet Lezha" ku Biblioteka "Gjergj Fishta", në bashkëpunim me DAR Lezhë, organizoi një takim të gjimnazistëve nga të gjitha shkollat e mesme të rrethit, me studuesin e veprës së Fishtës Dr.Tonin Çobani. Pse duhet ta njohim dhe ta duam Fishtën? Si ta lexojmë? Pse Lahuta e Malcisë është një vepër kombëtare dhe si ta shijojmë poetikën e Fishtës? Të gjitha këto pyetje morën përgjigje në këtë takim, ku të rinjtë interpretuan dhe krijime letrare të veprës së Fishtës. Ndërsa Klubi i Letrave vijoi edhe këtë vit traditën e mirë të "Ora e Muzës Lissus 2017", ku rreth 50 poetë e njerëz të letrave lexuan poezitë e tyre dhe vargje të Fishtës. Çmimin "Gjergj Fishta" e fitoi krijuesi Hekuran Koka me poezinë "Të Kërkosh Falje", ndërsa çmimin për poezinë dedikuar Fishtës e fitoi Dr. Martin Lleshi nga Kosova. I detyrohemi vetes dhe sidomos të rinjve, që të dimë ta tregojmë Fishtën, në përmasën e tij të vërtetë, atë që studuesit e quajnë Homeri dhe Dante Aligeri i shqiptarëve!

Dita Europiane e Gjuhëve të huaja

Në anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, greqisht, turqisht dhe gjuhë të tjera, nxënësit e Lezhës edhe këtë vit befaskan me recitime, këngë, informacione dhe loje teatrale, në Ditën Europiane të Gjuhëve të Huaja. Nga më të vegjëlit e shkollave 9-vjeçare e deri tek gjimnazistët, me numra të përzgjedhur pas koncerteve në shkollat e tyre dje, ata sollën sot në bibliotekë një buqetë të mrekullueshme interpretimesh në më shumë se 5 gjuhë të huaja. Sa gjuhë fliten sot në botë, si klasifikohen ato, si shkruhen dhe cilat janë gjuhët në zhdukje, na e treguan nxënësit e shkollës "Gjergj Kastrioti", bashkë me recitime dhe këngë. Nga Shkolla Kosova, Diosola shkëlqen me interpretimin e saj, ndërsa gjimnazistët e shkollës jopublike Rogacionistet, sollën mesazhe në 9 gjuhë të ndryshme, bashkë me vargje të Kipling dhe Nënë Terezës. Të gjithë bashkë duartrokitëm fort nxënësit e talentuar të mësuese Aishe Golemi nga gjimnazi "Hydajet Lezha", të cilët u paraqitën me një pjesë teatrale në anglisht, variacion mbi veprën e Shekspirit "Romeo dhe Zhulieta", duke zotëruar një tekst të vështirë, i cili erdhi përmes një interpretimi befasues të tyre.



14 vjetori i Ditës së Lumturimit të Nënë Terezës

Kjo nënë e përvuajtur e njerëzimit, e cila doli nga gjiri i një populli të lashtë, me kulturë, identitet dhe histori origjinale, të veçantë dhe të pandërprerë, asnjëherë nuk e fshehu origjinën e saj shqiptare. Gonxhe Bojaxhiu u bë nënë e njeriut të pambrojtur, nënë e njeriut të pashpresë, nënë e nevojtarit, e jetimit, e të sëmurit, e të pafuqishmit, nënë e të braktisurrit: nënë e tërë njerëzimit. Nënë Tereza është përjetësuar në mbarë Kombën Shqiptar dhe më gjërë si simbol i vlerave të larta njerëzore, i bujarisë, mëshirës, shpirtmadhësisë dhe flijimit për të tjerët. Nënë Tereza u shpall e "lumturuar" nga Papa Gjon Pali II, si simbol i ndihmës dhe respektit për "më të varfërit e të varfërve", të cilëve ajo iu kushtoi krejt jetën.



Dita Ndërkombëtare e të Drejtës së Informimit

28 shtatori është Dita Ndërkombëtare e të Drejtës për Informim. Kjo ditë përkon edhe me 3-vjetorin e miratimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Zbatimi i tij, është sfidë për të gjitha autoritetet publike për të kultivuar kulturën e transparencës ndaj publikut. Autoritete homologe dhe organizata jo fitimprurëse e kremtojnë atë duke organizuar aktivitete dhe nisma që promovojnë këtë të drejtë, si dhe nxisin përmirësimin e kuadrit rregullator për zbatimin e saj. Me këtë rast, zyra e Komisionerit ka krijuar një poster ndërgjegjësues i cili simbolizon lulen e mirëqeverisjes. Posterit do të vendoset sot në faqet zyrtare të internetit dhe rrjeteve sociale të autoriteve publike për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve në lidhje me ushtrimin e të drejtës së tyre për informim. Që nga miratimi i ligjit në shtator të vitit 2014, qytetarët shqiptarë kanë paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, 1407 ankesa, ku vetëm në 9-mujorin e fundit janë trajtuar 423 ankesa, të cilat në 90% të rasteve janë zgjidhur në favor të qytetarëve shqiptarë.

16

INTERNATIONAL DAY FOR
**UNIVERSAL
ACCESS TO
INFORMATION**

Festivali Epiko-Lirik i Matit

Këngët epike kanë një karakter të gjerë tregonjës. Ata pasqyrojnë ngjarjet e shumta dhe të ndryshme të jetës së një populli. Epika përfshin një fushë të gjerë dhe për këtë arsye ndahet sipas tematikës në tri degë kryesore: Këngët legjendare – këto këngë tregojnë historinë e kreshnikëve, e personazheve për të cilët nuk kemi të dhëna të caktuara historike. Këto histori për shkak të lashtësisë së tyre, megjithëse pasqyrojnë në të vërtetë ngjarje të jetës, janë shndërruar në legjenda, plot me elemente të mrekullueshme dhe përshkrime hiperbolike. Në to kanë hyrë elemente mitologjike të cilat pasqyrojnë besimin e hershëm të popullit. Në epikën legjendare hyjnë psh: Gjergj Elez Alia, këngët për bëmat e Mujit dhe Halilit etj. Edicioni i tretë i festivalit të këngës mbarëkombëtare epiko lirike në Mat u përfaqësua këtë vit nga Llesh e Gjin Prenga dhe, grupi i të rinjve. Festivali u zhvillua në dy ditë ku kënga epiko- lirike solli lashtësinë, ndjenjën, trimërinë dhe besën shqiptare.



Drejtoria e Shërbimeve Publike, Bashkia Lezhë

Në kuader të zbatimit të planit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Lezhë, pas vendosjes së kontenjerëve (koshave të mëdhenj) në çdo njësi administrative, po vijon vendosja e koshave të vegjël përgjatë rrugëve kryesore të qytetit Lezhë dhe Shëngjinit. Ftojme qytetarët që të na mbështesin në mbajtjen e mjedisit pastër dhe mos dëtimin e këtyre koshave. Një mjedis i pastër është produkt i asaj çfarë strukturat lokale dhe qytetarët realizojnë së bashku. Kjo ndërhyrje u krye gjatë muajit shtator me financimet e DLDP-së si pjesë e bashkëpunimit me OJQ dhe me mbështetjen e punëtorëve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike në qytetet e Lezhës dhe të Shëngjinit janë sistemuar 120 bazamente për vendosjen e kon-

tenierëve të plehrave të cilat janë vendosur përgjatë rrugëve si dhe vendosjen e 150 koshave të vegjël të cilat janë vendosur nëpër trotuare. Është bërë tashmë edhe inagurimi i kësaj qendre. Gjithashtu është punuar për të vënë në efikasitet plotë institucionet arsimore të rrethit të Lezhës duke plotësuar në përgjithësi kërkesat për një fillim të mbarë të vitit shkollor 2017-2018 duke ndërhyrë në: vendosje xhamash, lysterje klasash, riparime hidraulike, pastrime terriroresh në ambiente të jashtme, etj. Njëkohësisht po punohet nga ekipi inxhiniero-teknik për evidentimin dhe marrjen e masave për vënien në punë të sistemit të ngrohjes së institucioneve arsimore.



17

70-vjetori i studiuesit Tonin Çobani

Në mes të emocioneve të jashtëzakonshme dhe me ndonjë lot tinëzak gëzimi, Dr. Tonin Çobani hyri në Sallën "Gjergj Fishta" të bibliotekës së Lezhës, ku miqtë e priten me urimet më të mira për ditëlindjen e tij.

Me rastin e 70-vjetorit të lindjes, Këshilli Bashkiak i ka akorduar studiuesit të mirënjohur dr. Tonin Çobani, titullin "Qytetar Nderi i Lezhës". Në këtë festim me studiues, gazetarë, letrarë, krijues e miq të tij të shumtë nga Lezha dhe më gjërë, folësit iu rikthyen viteve të jetuara në Lezhë, ku Tonini bëri emër si mësues, studiues e shkrimtar. Ai punoi fort për t'i dhënë zë dhe dritë vlerave më të spikatura të Lezhës, ku përmes studimeve shumë dimensionale, dha kontributin e tij të vyer për të integruar në fondin e artë të kulturës tonë kombëtare vlerat

e Gjergj Fishtës, Pjeter Zarishtit e Frang Bardhit. Si Fishtolog i përkushtuar, studiues i Kanunit, Pjetër Zarishit e Frang Bardhit, Tonin Çobani erdhi në këtë takim me librin e tij të sapo nxjerrë nga botimi "Gjergj Fishta Fillimet Letrare", një tjetër hulumtim ky në fillimet e krijimtarisë letrare të Fishtës. I konsideruar emblemë e Lezhës, për punën jetegjatë në zbardhjen, studimin dhe lartësimin e këtyre figurave, që mbetën krenaria e Lezhës dhe kulturës sonë, të pranishmit e njohën Tonin Çobanin edhe si kompozitor me këngët e kompozuar ndër vite, kur mbesa e Toninit këndoi për të pranishmit bashkë me të gjithë sallën një kompozim të kahershëm të tij. Ashtu siç hyri në sallë, ashtu edhe doli, tejet i emocionuar, mes miqsh e dashamirësish që ia zbukuaruan këtë ditëlindje.



Shfaqje teatri tre planësh për fëmijë

Në Lezhë u soll për herë të parë teatri tre planësh për fëmijë. Shfaqja "Mendo për shëndetin tend", e realizuar nga Qendra Kulturore e Fëmijëve "Gjergj Lacaj" në Bashkinë Lezhë u prezantua në ditën botërore të shëndetit mendor. Në skenë u ngjiten 20 fëmijë dhe 10 të rritur që aktruan për fëmijët ndërsa synohej që të promovohet mënyra e shëndetshme e të ushqyerit. Kjo pjesë tërhoqi vemëndjen dhe duket se u kuptua edhe nga fëmijët. Ata e përjetuan bukur këtë ndjesi të parë këshilluese dhe argetuese për ta. Salla e mbushur me fëmijë dhe duartrokitjet e tyre treguan që kjo qendër po rikthehet në funksionin e vet, tha nënkryetarja e bashkisë, Alfrida Marku, e pranishme në shfaqje të premierës. Sipas saj në skenën e kësaj Qendre nuk po vijnë vetem risi, por shfaqje që kishin munguar prej vitesh. Eksperiencë e re, e bukur dhe mjaft emocionuese. Regjisori i shfaqjes, Klodian Marku, dhe scenografi, Tonin Kola, thonë se puna me fëmijët ishte diçka ndryshe por që do ta bënin sërish

me të njëjtin pasion dhe perkushtim. Ka qënë një eksperiencë e paprovuar me parë, e veçantë për mënyrën e realizuar dhe, sigurisht tejet emocionuese ndërsa shihje fëmijë që gëzojnë dhe shoqërojnë me kureshtje të gjithë shfaqjen. Realizimi për shfaqje të tilla është i vështirë, por për përgjegjësin e Qendrës Kulturore të fëmijëve në Lezhë, Marçel Lacaj, fakti që shfaqja u realizua tregon se kur ka vullnet gjithçka tejkalohet. Teatri tre planësh në Lezhë do të nisë menjëherë përgatitjet për realizimin e një tjetër shfaqjeje në kuadër të vitit të Skënderbeut dhe gjithçka do të jetë gati në 550 vjetorin e vdekjes së Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti. Shfaqja "Mendo për shëndetin tend" do të vijojë të jepet edhe për fëmijët e tjerë të kopshteve në Lezhë. Në kuadër të Ditës Botërore të Shëndetit Mendor, në sheshin para Bashkisë Lezhë, Qendra Kulturore e Fëmijëve "Gjergj Lacaj" vijoi me aktivitete të ndryshme sportive dhe artistike, ku krahas lojërave me top, përformoi dhe banda frymore e fëmijëve.



Aktivitetet sportive në Bashkinë Lezhë për vitin 2017

Sektori i sportit si gjithmone promovon dhe zhvillon aktivite sportive të ndryshme në qytetin tonë duke i dhënë vlera, gjallëri dhe energji qytetit dhe rinisë. Në muajin gusht specialistët e sportit, Altin Pergjergji dhe Klajti Reçi, organizuan rrëshqitje në Ranën e Hedhun, një sport sa argëtues aq edhe ekstrem nga vetë pozicioni ku u zhvillua. Pjesëmarrja ishte e madhe dhe ishte e moshave të ndryshme. Morën pjesë edhe turistë të cilët u prononcuan për këtë aktivitet që ishte hera e parë që organizohej. Edhe pse kishte vështirësi në organizim dhe realizim, çunat e sportit ia arritën. Gjithashtu, në lumin Drin për herë të parë specialistët e sportit në Bashkinë Lezhë sollën Garën me Kajakë, një risi në Lezhë. Ky aktivitet u prit shumë pozitivisht dhe kishte pjesëmarrje të madhe. Qytetarët e shikuan si një mundësi të mirë për ta kthyer në traditë levizjen me kajakë apo varka në mënyrë që ta bëjmë më të lundrueshëm lumin. Ky aktivitet i shtoi gjallërinë lumit Drin, i cili përshkon më së përmes qytetin. Në shtator është vijuar më tej me Ditën Botërore pa makinën time. Specialistët e sportit organizuan një ecje me biçikleta në qytet, pastaj vijoi me një ecje maratonë për 30 km nga Obelisku deri në Fishtë te

shtëpia e At Gjergj Fishtës. Kishte pjesëmarrje të mirë dhe mesazhi ishte i qarte, që të fillojmë të lejmë makinat dhe të ecim me biçikleta për një qytet më të pastër dhe shëndet të mirë. Data 15 gusht mban emrin e festës së përvitshme “Dita e Shtegtarëve” ku specialistët e sportit zhvilluan ndeshje futbollit ndërmjet komunitetit dhe emigrantëve. Një ndeshje e cila zhvillohet çdo vit dhe pritet me emocion nga të gjithë. Pjesëmarrësit janë shprehur pozitivisht, duke thënë që lojërat, humori dhe argëtimet kanë qënë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj feste. Fundi i muajit shtator u mbyll me një aktivitet të veçantë dhe të dhimbshëm pasi ishte përkujtimore e sportistes, vogëlushes Klarisa e cila, para 6 muajve humbi jetën aksidentalisht. Trajneri i ekipit Besëlidhja Judo, Altin Pergjergji organizoi një aktivitet në emër të saj me titullin “Klarisa Judo Fest” ku morën pjesë fëmijë nga gjithë Shqipëria. Kishte të ftuar nga administrata dhe drejtues të lartë të federatës, familjarë të vogëlushes dhe qytetarë. Të kujtojmë vogëlushen, të promovojmë sportin dhe fëmijët duke treguar vlerat e Klarisës që u largua nga jeta, duke treguar sa shumë ajo e donte sportin dhe jetën.



Judo “Besëlidhja”

Ekipi Besëlidhja përfaqësoi Shqipërinë në turneun ndërkombëtar Prilep Maqedoni “Prilep-City.Hero 2017” Sport Hall of MPS “DOBREYOVANOSKI”.

Ekipi i Lezhës ishte i vetmi ekip shqiptar pjesëmarrës në këtë turne. Morën pjesë 7 shtete Ballkanike me një pjesëmarrje rreth 20 klube. “Besëlidhja” Lezhë u përfaqësua nga tre sportistë, trajnerin A.Pergjergji dhe, doktori i ekipit, E.Bushi.

Luigj Vataj, kampion tre fitore:

- 1) Vataj ALB vs Mustafa KOS
- 2) Vataj ALB vs Sider BUL
- 3) Vataj ALB vs Todorov BUL

Martin Prendi, kampion tre fitore:

- 1) Prendi ALB vs Zarogos GRE
- 2) Prendi ALB vs Petroski BUL
- 3) Prendi ALB vs Kotzanristous GRE

Aleksander Gjeçi, vendi i tretë, dy fitore, një humbje:

- 1) Gjeçi ALB vs Mustafa KOS
- 2) Gjeçi ALB vs Velio KOS
- 3) Gjeçi ALB vs Bejta KOS

Trajneri Altin Pergjergji shprehet:

- Ekipi ynë bëri një përfaqësim shumë dinjitoz dhe, falë punës serioze erdhi dhe rezultati 4-3 . Tre sportistët arritën të sjellin në Lezhë tre medalje, dy medalje ari dhe një bronzi.

- Jam shumë i kënaqur me rezultatet pasi u pasqyrua puna ime dhe e kolegut E.Koca dhe besoj që çdo lezhjan duhet të kënaqet kur ne i përfaqësojmë me kaq seriozitet.

- Aktiviteti i radhës, për kampionin Vataj. Është pas dy javësh kampionati Botëror në Kroaci për moshat U21 ku Vataj do garojë me moshën më të rritur pasi ai aktualisht është vetëm 15 vjeç . Një falenderim për prindërit e sportistëve pasi shpenzimet janë mbuluar nga vetë sportistët.

Turneu “Klarisa Judo Fest”

Ky turne do të bëhet pjesë e kalendarit vjetor të Federatës Shqiptare të Judos që të ketë dhe Lezha një aktivitet kombëtar për fëmijë. Të ftuarit mbajtën disa fjalime në kujtim të vogëlushes Klarisa duke përcjellë dhe mesazhe për të gjithë të pranishmit. Në mbyllje, trajneri A.Pergjergji përmendi një pjesë të vlerave dhe kujtimeve të sportistes dhe njëkohësisht dhe mbesës së tij Klarisës, duke përcjellë një mesazh shumë të fortë për të gjithë. Në këtë turne morën pjesë:

- Prefekti Eduart, Ndreca
- Drejtori i Arsimit, Bardhok Pulaj
- Drejtori i Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për Bashkinë Lezhë, Ardian Laçi
- Kryetari i Këshillit, Kristjan Gjidodaj
- Presidenti i FSHJ, Met Harizi
- Sekretari i FSHJ, Labo Çapo
- Përfaqësues nga të gjithë ekipet e judos në Shqipëri





Bashkia Lezhë,
Lagjia Skënderbeg,
Sheshi "Gjergj Kastrioti",
4501, Lezhë,
info@lezha.gov.al
www.lezha.gov.al